



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1000/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Vijator” d.o.o, me seli në Preshevë, Serbi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shpetim Mehmeti, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “DT Mining” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811287350 dhe seli në Caradovicë, Komuna Obliqi, rr. ”Minierat”, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 853/21, i lejuar me datë 11.05.2021, nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 23.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “DT Mining” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811287350, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 853/21, i lejuar me datë 11.05.2021, nga Përmbartuesi Privat Flamur Bogaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën Faturës nr. 1176/19, e datës 13.06.2019, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 853/21, të datës 11.05.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që menjëherë pas pranimit të urdhit, kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit të mbetur në vlerë prej EUR 4,500.00, me kamatëvonesë prej 8% duke filluar nga data 10.05.2021 e deri në përmbushje definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimor dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 156.00

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk përbën titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përmbartimin ndaj debitorit. Me tej, ka theksuar se fatura mbi bazën e së cilës mbështetet urdhri nuk paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 të LPP-së. Ka shtuar se debitori ka përmbushur një pjesë të detyrimit ndaj kreditorit për çka eksitojnë edhe

dëshmitë e fletë pagesave bankare, ashtu që borxhi i kërkuar nga kreditori nuk është real dhe se kreditori ka iniciuar procedurë mbi bazën e faturës për të cilën një pjesë e pagesës është përmbushur. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim të paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se pretendimet e paraqitura nga debitori janë të pabazuara. Ka shtuar se kreditori ka deponuar të gjitha dëshmitë me anë të të cilave lehtësisht vërtetohet kërkesa e kreditorit, ndërsa përmes përgjigjes në prapësim ka dorëzuar edhe kartelën financiare nga ku rezulton se borxhi i debitorit është në lartësinë e kërkuar me propozim për përmbarim. Në fund, ka theksuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për ti mbështetur pretendimet e paraqitura në prapësim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjykata gjen se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr.1176/19, e datës 13.06.2019 mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase nuk mund të vërtetohet që e njëjta është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se është pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtës iu mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturën në fjalë. Rrjedhimisht, fatura e

lëshuara nga kreditori, mirëpo jo e pranuar nga debitori përbën dokument të njëanshëm dhe, si e tillë, nuk është e përshtatshme për përmbarrim.

Gjykata ka vlerësuar edhe dokumentet të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarrim, përkatësisht dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR), mirëpo gjeti se të njejtat paraqesin dëshmi na raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturën mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga kjo faturë. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se procedura përmbarrimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarrimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21 dhe 29 të LPP-së.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk kanë tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1000/22, datë 23.10.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.